**VENDIM**
**Nr.1108, datë 30.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT KALOJNË NË PRONËSI TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES, SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8,13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., sipas lidhjeve (gjithsej 1416 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të sistemit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH sh.a.-së, miratuar me vendimin nr.122, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave, të pronave, që i përkasin sistemit të shpërndarjes, sipas fletëve, të përcaktuara në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të prodhimit dhe të transmetimit të energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH sh.a.-së, ndryshohen të dhënat për pronat, sipas tabelave (gjithsej 3 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

SHTOJCA NR.1

- 118-154;
- 157;
- 158 (pronat nr.5 e nr.6);
- 159;
- 160 (prona nr,2);
- 161-166;
- 168-179;
- 180 (pronat nr.2 e nr.3);
- 181-182;
- 183 (pronat nr.2, nr.3 e nr.4);
- 184-259;
- 261-284;
- 285;

286 (pronat nr.1/6, nr.1/7, nr.1/8, nr.1/9, nr.1/10, nr.1/11, nr.1/15 e nr.1/16);
287-449;
- 450 (pronat nr.1.21, nr.1.22, nr.1.23, nr.1.24, nr.2.1, e nr.2.2);

451-618;
- 625-690;
- 692-735;
- 737-1 352.

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE, KESH sh.a.
Bashkia: Tiranë
Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a.

Identifikoi: Erion Bozgo Shef Sektori
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Çlirim Çomo Drejtor i DPP
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel,firma,vula)

| | A | | B | | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Zona kadastr&Indeksi i hartës | Nr.i pasurisë | Emërtesa e pronës, vendndodhja, shtrirja gjeografike | Komponentët përbërës të pronës | Adresa, vendndodhja e komponentëve përbërës | Përmasat e pronës në $m^2$ ose ml | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni,enti me përgjegjësi administrative | Institucioni,enti përdorues, statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | | | | | | | | METE KESH sh.a. | KESH sh.a. | |
| 1 | | | | Godina e Institutit të Energjetikës | Blloku “Vasil Shanto” | 320 $m^2$ | Zyra e administratës qendrore të KESH | “ | “ | Sip.ndërtimi 320 $m^2$ një katëshe |
| | | | | | | | | | | |

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(të tipit të pronave që inventariziohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE, KESH sh.a.
Komuna: Qendër-Fier
Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a.

Identifikoi: Erion Bozgo Shef Sektori
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Çlirim Çomo Drejtor i DPP
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma,vula)

| | A | | B | | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Zona kadastr&Indeksi i hartës | Nr.i pasurisë | Emërtesa e pronës, vendndodhja, shtrirja gjeografike | Komponentët përbërës të pronës | Adresa, vendndodhja e komponentëve përbërës | Përmasat e pronës në $m^2$ ose ml | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni, enti me përgjegjësi administrative | Institucioni,enti përdorues,statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | | | | | | | | METE KESH sh.a | KESH sh.a. | |
| 1 | | | TEC FIER | TEC FIER | Komuna Qendër Fshati Drizë | 170.950 $m^2$ | Prodhim energjie | “ | “ | |
| | | | | | | | | | | |

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE, KESH sh.a.
Bashkia: Tiranë
Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a.

Identifikoi: Erion Bozgo Shef Sektori
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Çlirim Çomo Drejtor i DPP
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

| | A | | B | | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Zona kadastr&Indeksi i hartës | Nr.i pasurisë | Emërtesa e pronës, vendndodhja, shtrirja gjeografike | Komponentët përbërës të pronës | Adresa, vendndodhja e komponentëve përbërës | Përmasat e pronës në $m^2$ ose ml | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni, enti me përgjegjësi administrative | Institucioni,enti përdorues, statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | | | | | | | | METE KESH sh.a. | KESH sh.a. | |
| 1 | | | | Magazinat 6, | Bashkia | 9100 | Për magazina | “ | “ | Sip.ndërtimi |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 7, 8, 9, 10 | Tiranë pranë qytetit të nxënësve Selitë | | | | | 1600 $m^2$ |
| | | | | | | | | | | |